



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.95, datë 09.05.2022

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR VLERËSIMIN ETIK DHE  
PROFESIONAL TË PROKURORËVE”**

Bazuar në nenin 149, pika 1 germa “a” të Kushtetutës, në nenet 159 pika 2 germa “a” dhe “e”, 164 pika 8, 184 germa “dh”, 189 pika 1, germa “c”, të ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar, si dhe në nenet 25, 68-71, 73-78, 84-95, 97 dhe 171, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me propozimin e Grupit të Punës ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.51, datë 19.02.2021, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot më 09.05.2022.

**KRYETARI**

